



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:004388
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05419923

C.nr. 2125/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin individual Fuad Haliti, në çështjen juridike të paditësit J.G nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Uvejs Gashi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, baza juridike, kompensim i shtesave në pagë në emër të licencimit, më datë 06.03.2024 jashtë seancës gjyqësore nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. **APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE** me numër C.nr.2125/23 e datës 12.01.2024 (Nd:658/2023) e arritur në procedurën e ndërmjetësimit, në mes të të paditësit J.G nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Uvejs Gashi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me bazë juridike kompensim i shtesave në pagë në emër të licencimit, dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

Arsyetim

Paditësit me datën 22.12.2023 pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padinë për kompensim i shtesave në pagë në emër të licencimit.

Me datën 12.01.2024, gjykata është njoftuar se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit pranë ndërmjetësuesit Edmond Kumanova, i cili këtë marrëveshje me shkrim i'a ka dorëzuar gjykatës.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të cilat gjinden në lëndë konsiderojë se janë plotësuar kushtet për aprovimin e kësaj marrëveshje të arritur në procedurën e ndërmjetësimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 15 paragrafi 4 i Ligjit për Ndërmjetësimin “Nëse Ndërmjetësimi fillon me vetëinicimin e palëve, marrëveshja e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, e cila përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes, ka fuqinë e dokumentit përmbarues në përputhje me ligjin përkatës për procedurën përmbarimore.”

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.2125/23, me datë 06.03.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta në ankesë.